



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:215226  
Datë: 22.01.2024  
Numri i dokumentit: 05218995

**PA1.nr. 967/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarve H.J. nga Skenderaji, për shkak të veprës penale në tentativë Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarit R.J., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së të akuzuarit H.J. dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit R.J., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, P.nr. 283/2021 të datës 28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11 Janar 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen si të pabazuara** ankesa e të akuzuarit H.J. dhe ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit R.J., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, P.nr. 283/2021 të datës 28.04.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, P.nr. 283/2021 të datës 28.04.2023, i akuzuari H.J., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale në tentativë Sulmi nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 28 par.1 të KPRK-së, për të cilën cilen i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj me kusht se i njëjti dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër vepër penale. I akuzuari R.J., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, për të cilën cilen i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj me kusht se i njëjti dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër vepër penale

Të akuzuarit janë obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale të cilat dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumen prej nga 70 ( shtatëdhjetë) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumen prej nga 20 ( njëzet ) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar A.M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar :**

I akuzuari H.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza apo aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.J., av.Shefqet Ibrahimit nga Skenderaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza apo aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit H.J. dhe ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit R.J., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1004/23 të datës 08.08.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit të Kosovës, ankesën e të akuzuarit H.J. dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit R.J., t'i refuzoj si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-se, në të cilën nuk prezantuan askush nga palët edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt në pajtim me nenin 390 paragrafi 4 të KPPRK-se.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të të akuzuarit H.J. dhe ato të mbrojtësit së të akuzuarit R.J., dhe gjeti se :

#### **- Ankesat nuk janë të bazuara.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të akuzuarit H.J., me ankesë pretendon se aktgjykimi shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën par.1.12 e lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar është i pakuptueshëm, është kundërthënë në brendinë e tij dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit. Sipas të akuzuarit në aktgjykim nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare ndërsa arsyet e paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe në masë të konsiderueshme kundërthënëse. Sipas të akuzuarit Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin

e ankimuar nuk i ka paraqitur ne mënyre te plote faktet e vërtetuara dhe te pa vërtetuara, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Sa i përket shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale mbrojtësi i akuzuarit R.J., av.Shefqet Ibrahim, me ankese pretendon se aktgjykimi shkalles se pare është i përfshire me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën par.1.12 e lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar është i pakuptueshëm, është kundërthënës ne brendinë e tij dhe me arsyet e paraqitura ne arsyetimin e aktgjykimit. Sipas mbrojtësit së të akuzuarit në aktgjykim nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare ndërsa arsyet e paraqitura janë plotësisht te paqarta dhe ne masë të konsiderueshme kundërthënëse. Sipas mbrojtësit së të akuzuarit Gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e ankimuar nuk i ka paraqitur ne mënyre te plote faktet e vërtetuara dhe te pa vërtetuara, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të akuzuarit H.J. si dhe ato të mbrojtësit së të akuzuarit R.J., av.Shefqet Ibrahim, lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare është i qarte dhe i kuptueshëm dhe si i tille përmban arsye te mjaftueshme përkitazi me faktet relevante te kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga te cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave te ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura ne ankesa nuk janë te natyrës se tille për te konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi te atilla procedurale qe do ta bënin te paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. Gjykata e shkalles se pare ne mënyre te drejte dhe te plote i ka vërtetuar te gjitha faktet vendimtare te kësaj çështje dhe se eshte mbështetur ne provat e administruara si dëgjimin e të dëmtuarit ne cilësinë e dëshmitarit A.M. dhe dëshmitareve M.Gj. dhe L.M., shikimi i foto albumit nga vendi i ngjarjes, leximi i certifikatës të zonës kadastrale ne Drenas i datës 30.01.2014 ne emër te Rr.M., shikimi i skicës dhe shikimi i CD-së me foto nga vendi i ngjarjes. Andaj pretendimet ankimore lidhur me mos vërtetimin e fakteve vendimtare lidhur me kete çështje, Gjykata e Apelit i refuzoi si te pabazuara.

Sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, i akuzuari H.J. dhe mbrojtësi i të akuzuarit R.J., pretendojnë se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes se ligjit penal ne dem te të akuzuarit ka ardhur deri te vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase nuk është vërtetuar fakti se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe janë shpallur fajtorë, siç është pretenduar në aktakuzë e që këto fakte nuk janë vërtetuar as pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve e as ne video incizimet e dorëzuar nga pala e dëmtuar nuk eshte e qartë se çfarë kanë pasur ne duar të akuzuarit apo me çka e kane sulmuar të dëmtuarin andaj gjykata sipas të akuzuarit H.J. dhe mbrojtësit së të akuzuarit R.J., të njëjtit i ka shpallur fajtor pa u plotësuar elementet e veprave penale për të cilat janë akuzuar dhe shpallur fajtorë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të akuzuarit H.J. dhe mbrojtësit së të akuzuarit R.J., lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase janë ne kundërshtim me provat e administruara nga gjykata e shkalles se pare si dëgjimin e të dëmtuarit ne cilësinë e dëshmitarit A.M. dhe dëshmitareve M.Gj. dhe L.M., shikimi i foto albumit nga vendi i

ngjarjes, leximi i certifikatës të zonës kadastrale ne Drenas i datës 30.01.2014 ne emër te Rr.M., shikimi i skicës dhe shikimi i CD-së me foto nga vendi i ngjarjes, e ne baze te te cilave konstatohet se gjykata e shkalles se pare, drejte dhe ne mënyre te plote ka vërtetuar gjendjen faktike ne rastin konkret, andaj edhe pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike i refuzoi si te pabazuara si dhe konstatoi se ne rastin konkret kur të akuzuarit janë shpallur fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, për çka edhe pretendimet e të akuzuarit H.J. dhe mbrojtësit së të akuzuarit R.J. lidhur me shkeljen e ligjit penal në dëm të të akuzuarve i refuzoi si të pabazuara ngase ne veprimet e te akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive te veprave penale per te cilat janë shpallur fajtorë.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, i akuzuari H.J. si dhe mbrojtësi i të akuzuarit R.J., me ankesë nuk e elaborojnë vendimin mbi sanksionin penal ngase te njëjtit pretendojnë se ne rastin konkret eshte dashur qe te lirohen nga akuza ne mungese te provave, megjithatë Gjykata e Apelit aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare e vlerësoi edhe ne këtë aspekt dhe konstatoi se gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes ne lidhje me sanksionin penal ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese te parapara me nenin 69 dhe 70 te KPRK-se e te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerëses nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i saj, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.967/23 më 11.01.2024**

**Procesmbajtës**  
**Arben Arifi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit**  
**Zyhdi Haziri**

---

**Ferit Osmani**

---